



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 13.06.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Vjosa Osmani, Alma Lama, Blerim Shala dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj, Blerta Deliu – Kodra, Suzana Novobërdali dhe Nekibe Kelmendi.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha – koordinatore, Safet Beqiri – zyrtar për Integrime Evropiane dhe Pajtim Gashi - praktikant.

Pjesëmarrës të tjerë: Rexhep Bllaca, Dritro Arifi, Kevin Leary dhe Juliane Echblah – Ministria e Integrimit Evropian; Ganimete Heseti – KDI; Sanije Berisha – OSBE; Arban Abrashi dhe Venera Mjekiçi – Kuvendi.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri – kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

R E N D I I D I T Ë S:

- 1. Miratimi i Rendit të Ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/7-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/7-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për Akreditim, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-004 për Shërbimet e sigurisë private, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e brendshme, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;**

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-014 për eficiencën e energjisë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua me këto ndryshime, duke shtuar një pikë të rendit të ditës. Pika 8 Shqyrtimin e Projektligjit për gjendjen civile me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 18.05.2011 me një vërejtje të deputetes Alma Lama.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/7-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;

Kryetari tha se projektligji nr. 04/7-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, pasi që nuk është në kundërshtim me Acquis Communautaire mund të procedohet më tutje, megjithëse ka disa gabime drejtshkrimore.

Kryetari hapi debati në lidhje me këtë projektligj.

Alma Lama tha se ky projektligj së bashku me amendamentet e komisionit funksional ka gabime të shumta drejtshkrimore, të cilat shpeshherë edhe i humbin kuptimin këtij projektligji.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/7-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL është i harmonizuar me Acquis Communautaire.

4. Shqyrtimi i projektligjit nr. 04/7-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;

Kryetari tha se projektligji nr. 04/7-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk përbën shkelje të parimeve të përgjithshme të BE- së.

Kryetari hapi debati në lidhje me këtë projektligj.

Alma Lama po ashtu bëri vërejtje në aspektin drejtshkrimor të Projektligjit dhe amendamenteve të komisionit funksional.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/7-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim, me amendamentet e Komisionit Funkcional është i harmonizuar me Acquis Communautaire.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-004 për shërbimet e sigurisë private, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;

Kryetari pohoj se projektligji nr. 04/L-004 për shërbimet e sigurisë private, me amendamentet e Komisionit Funkcional, përveç vërejtjeve drejtshkrimore pasi që nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE- së, mund të miratohet.

Kryetari hapi debati në lidhje me këtë projektligj.

Alma Lama theksoj po ashtu se edhe ky projektligj së bashku me amendamentet e komisionit funksional ka gabime drejtshkrimore, po ashtu edhe në titullin e këtij projektligji.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-004 për shërbimet e sigurisë private, me amendamentet e Komisionit Funkcional me disa gabime drejtshkrimore është në harmoni me Acquis Communautaire.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;

Kryetari ftoi deputetin Albert Kinolli, referues i këtij projektligji, të paraqes Raportin për këtë projektligj.

Albert Kinolli tha se ky projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional pas shqyrtimit konstatoi se nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Alma Lama tha se edhe ky projektligj me amendamentet e komisionit funksional ka gabime drejtshkrimore.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme, me amendamentet e Komisionit Funksional është në harmoni me Acquis Communautaire.

7. Shqyrtimi i projektligjit nr. 04/L-014 për eficiencën e energjisë, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;

Kryetari tha se projektligji nr. 04/L-014 për eficiencën e energjisë, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional përveç gabimeve drejtshkrimore që ka, nuk përbën shkelje të parimeve bazë të Acquis Communautaire, prandaj hedhet për miratim.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-014 për eficiencën e energjisë, me amendamentet e Komisionit Funksional është në harmoni me Acquis Communautaire.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për gjendjen civile, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;

Kryetari tha se ky projektligj parashihet që të futet për miratim në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës, po ashtu është paraparë edhe me Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës për vitin 2011. Ky projektligj ka ardhur sot dhe pas shqyrtimit është vërejtur se nuk paraqet shkelje të parimeve të përgjithshme të BE-së, prandaj rekomandohet për miratim.

Kryetari konstatoi se Komisioni me shumicë të votave nxori këtë

Përfundim

Projektligji për gjendjen civile, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional është në harmoni me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së.

9. Të ndryshme;

Vjosa Osmani kërkoi që të gjitha ligjet dhe amendamentet, si dhe materialet e tjera për anëtarët e Komisionit të dërgohen në formë elektronike, sapo të caktohet rendi i ditës.

Alma Lama kërkoi të informohet me shkrim rreth organizatave të ndryshme që mbështesin punën e Komisionit për Integritet Evropian, llojin e mbështetjes, cilat fusha etj.

Kryetari kërkoi nga anëtarët e Komisionit që takimet e rregullta të Komisionit të mbahen ditën e martë, si ditë më e përshtatshme.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri